



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 25.10.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR DEKRETIN NR. 10908, DATË 11.10.2018, E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 37/2018 “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË PËR VLERËSIMIN, NEGOCIMIN DHE LIDHJEN E KONTRATËS ME OBJEKT “PROJEKTIMI DHE REALIZIMI I PROJEKTIT URBAN DHE GODINËS SË RE TË TEATRIT KOMBËTAR”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, shqyrtoi dekretin nr.10908, datë 11.10.2018, e presidentit të Republikës së Shqipërisë, “Për kthimin e ligjit nr.37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të teatrit kombëtar”, në mbledhjen e datës 25 tetor 2018.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrton këtë Dekret në cilësinë e komisionit përgjegjës që ka shqyrtuar fillimisht projektligjin, sipas përcaktimeve të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit.

Sipas nenit 86, Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimit paraqet Raportin e tij.

Komisioni caktoi relator për shqyrtimin e Dekretit deputetin Ilir Beqaj.

Në fjalën e tij relatori u shpreh, së pari, lidhur me kushtetueshmërinë e dekretit të presidentit, referuar përcaktimeve të nenit 85, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe lidhur me faktin se Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe mjedisin është shprehur lidhur me arsyet e kthimit të ligjit 37/2018 gjatë shqyrtimit të dekretit nr. 10849, datë 27.7.2018, duke bërë dhe ndryshimet përkatëse në ligj.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm, vendosi t’i rekomandojë seancës plenare **rrëzimin e dekretit** të Presidentit të

Republikës, nr.10908, datë 11.10.2018, “Për kthimin e ligjit nr.37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të teatrit kombëtar”,

Ilir BEQAJ

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar